



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/7
Nr. _____/Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 556, datë 28.10.2025

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË DHE TË KURRIKULËS ME ZGJEDHJE, TË
ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Gjuhë shqipe”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Letërsi”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

5. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Kimi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë dhe klasën e dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Programet mësimore të klasës së dhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
18. Programet mësimore të klasës së njëmbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
19. Programet mësimore të klasës së dymbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2028 – 2029.
20. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “MUZIKË” ARSIMI I MESËM I LARTË (ME ZGJEDHJE) KLASAT 10/11/12

FUSHA “ARTET”

Koordinator: Marina Topulli



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1	HYRJE.....	5
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	7
	2.1 Objektivat e përgjithshme të lëndës	8
3	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	9
4	KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E MUZIKËS	12
	4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.....	12
	4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e muzikës	18
	4.3 Kompetencat e lëndës “Muzikë” dhe aftësitë e shekullit XXI që zhvillohen përmes saj	20
	4.4 Kompetencat e lëndës së muzikës dhe rezultatet e të nxënit.....	21
5	PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	27
	5.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë	27
	5.2 Përmbajtja e lëndës sipas tematikave dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre	28
	5.2.1 Tematikat: Gjuha dhe komunikimi – Teknika dhe procese – Historia, muzika dhe shoqëria	29

5.3	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).	36
6	METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	39
6.1	Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e muzikës.	39
6.2	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e muzikës	41
6.3	Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e muzikës	42
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE	42
7.1	Llojet e vlerësimit në lëndën e muzikës	43
7.2	Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e muzikës	44
7.3	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.	45
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE	46
9	REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	48
10	NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE	50

Përmbajtja e tabelave

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.	13
Tabela 2: Kompetencat muzikore dhe rezultatet e të nxënit	23
Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë	27
Tabela 5. Shembull i veprimtarive për përmbushjen e RN-ve.....	36
Tabela 6. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve	45

Përmbajtja e diagrameve

Diagrama 1. Përmbajtja e programi lëndor të muzikës.....	10
Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së muzikës	22
Diagrama 3. Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit	38

1 HYRJE

Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit. Muzika është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që edukon dhe formon nxënësit nga ana muzikore, duke i orientuar për të zhvilluar dhe krijuar njohuri për kuptimin e veçorive të ligjërit muzikor nga më e thjeshta te më e ndërlikuara përmes gjuhës dhe komunikimit muzikor, drejt marrjes pjesë dhe interpretimit në veprimtaritë muzikore individuale dhe në grup përmes teknikave dhe procesit muzikor, për formimin dhe krijimin e një gjykimi dhe qëndrimi artistik ndaj veprave të muzikës shqiptare dhe asaj botërore, përmes formave dhe gjinive të ndryshme muzikore. Njohja në mënyrë të thelluar e muzikës ndihmon në zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

Muzika është e pranishme kudo në jetën tonë të përditshme (p.sh. klasë, shtëpi, TV, film, koncert, teatër, kolonë zanore, ngjarje të shënuara familjare, veprimtari brenda dhe jashtë shkollës, ngjarje të komunitetit etj.).

Muzika nuk mund të kuptohet dhe realizohet duke marrë vetëm disa njohuri, por duke vazhduar njohjen më të plotë të saj përmes *gjuhës muzikore dhe komunikimit* nëpërmjet saj të njohjes me veprat muzikore, *teknikave dhe proceseve* nëpër të cilat zhvillohet muzika. kjo realizohet nëpërmjet dëgjimit të veprave muzikore dhe kuptimit të tyre sipas formës, gjinisë dhe stilit, *njohjes me zhvillimin kulturor dhe historik të muzikës*, që e bëjnë të vetëdijshëm nxënësin për rolin e muzikës në jetën e përditshme, dhe vlerësimin e saj nëpërmjet një gjuhe të saktë muzikore.

Muzika është arti që shprehet me *tinguj*, ndaj, të gjitha krijimet muzikore përvetësohen me anë të dëgjimit dhe përjetohen shpirtërisht. *Tingulli* është *mjeti shprehës*, i cili zhvillohet përmes cilësive të tij *kohëzgjatja, lartësia, forca dhe timbri*. Kuptimi i drejtë i cilësive të tingujve dhe harmonisë së tyre në një melodi/vepër muzikore kërkon dëgjimin e kujdesshëm të veprave muzikore dhe përqendrimin e vëmendjes tek to.

Familjarizimi dhe përvetësimi i veprës muzikore, buron nga fakti, se ndikimi i saj tek dëgjuesi është i trefishtë: *shqisor, emocional dhe shpirtëror*, gjë që sjell edhe përjetimin e trefishtë. Përjetimi emocional i muzikës është i lidhur ngushtë me përjetimin shqisor, prandaj mendohet se muzika, më shumë se të gjitha artet e tjera, nxit drejtpërdrejt ndjenjat e njeriut dhe u drejtohet pikërisht atyre.

Edhe pse përjetimi emocional ka forcë dhe rëndësi të madhe, për përjetimin e plotë të veprës muzikore si krijim artistik i shpirtit të njeriut, është i domosdoshëm edhe kundërveprimi shpirtëror i dëgjuesit dhe kërkohet pjesëmarrja e tij e vetëdijshme dhe aktive. Duhet ndjekur me vëmendje dhe duhen lidhur të gjithë faktorët që përbëjnë një vepër muzikore, bukuria e kombinimit emocional të tingujve, forma dhe konceptimi i saj si një e tërë, bën që nxënësit të kuptojnë më së miri mesazhin që mbart dhe përcjell vepra muzikore.

Shumë rëndësi ka koha në të cilën është krijuar vepra, autori, zhvillimi historik, politik, social kulturor, të cilat japin një panoramë më të qartë si dhe krijojnë një kuptim, duke realizuar më të plotë përjetimin shqisor, emocional dhe shpirtëror të veprës muzikore.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Qëllimi i muzikës në arsimin të mesëm të lartë është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e kulturës muzikore të nxënësve. Mësimi i muzikës në klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë vazhdon të edukojë nxënësin nga pikëpamja estetike dhe muzikore, duke i orientuar ata në mënyrë të saktë drejt kuptimit të vlerave estetike dhe veçorive të ligjërimit muzikor nga abstraktja të konkretja, në njohjen me gjinitë dhe llojet e ndryshme të muzikës, si dhe duke u njohur me zhvillimin historik të muzikës në kontekste dhe kultura të ndryshme.

Muzika si gjuhë universale mundëson:

- përjetimin dhe vlerësimin e vlerave të muzikës kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, për ta ruajtur dhe për ta kultivuar identitetin kombëtar, si dhe duke zhvilluar aftësitë e përjetimit *estetik dhe vlerësimit kritik*;
- përjetimin dhe vlerësimin e muzikës e epokave të ndryshme sipas stilit, gjinive dhe llojeve muzikore, duke zhvilluar aftësitë e përfytyrimeve dhe përjetimeve muzikore;
- zhvillimin e aftësive bashkëpunuese në krijimin e raporteve ndërmjet kulturave, duke ndërvepruar në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- kuptimin e formave të ndryshme të veprimtarisë muzikore duke zhvilluar aftësitë krijuese, individuale;
- zhvillimin e kompetencave muzikore për krijimin dhe realizimin e punëve të ndryshme muzikore, si: përmbledhje nga vepra të ndryshme muzikore shqiptare apo botërore;
- pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke vënë në shërbim të mjedisit ku jeton aftësitë dhe talentin e vet;
- dhënien e kontributit personal në zhvillimet artistike muzikore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

2.1 Objektivat e përgjithshme të lëndës

Objektivat e përgjithshme që synohen të arrihen në përfundim të klasës së dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë kërkon që nxënësit:

- Të zhvillojnë ndjeshmërinë estetike, emocionale dhe muzikore përmes dëgjimit, këndimit dhe interpretimit.
- Të përvetësojnë njohuritë themelore muzikore (ritmet e thjeshta, notat muzikore, shkalla muzikore, melodi, dinamikë).
- Të formojnë kulturë muzikore përmes njohjes së stileve, zhanreve dhe traditave muzikore kombëtare e botërore.
- Të zhvillojnë aftësitë për të dëgjuar, analizuar dhe interpretuar muzikë.
- Të mësojnë të bashkëpunojnë në grup dhe të respektojnë rregullat muzikore si gjatë këndimit ashtu edhe në luajtjen përmes instrumenteve.
- Të zhvillojnë aftësitë për interpretim vokal dhe instrumental që zhvillojnë frymën e grupit dhe përgjegjësinë e ndërsjellë.
- Të zhvillojnë ndjenjën e krijimtarisë muzikore dhe shprehjes personale përmes improvizimit dhe kompozimit.
- Të zhvillojnë aftësitë kritike dhe analitike përmes aktiviteteve të ndryshme muzikore. (për këtë grup moshë)¹.
- Të shprehin emocionet e tyre ndaj muzikës që dëgjojnë sipas zhanreve të ndryshme: popullore, për të rinj, klasike, moderne këngë e lehtë etj.
- Të zhvillojnë aftësitë krijuese në krijimin dhe improvizimin e muzikës, përmes aktiviteteve të ndryshme muzikore.
- Të mësojnë ndërtimin e qëndrimeve pozitive ndaj mësimit të muzikës dhe përfshirjes në jetën kulturore.

¹ Veprat muzikore duhet të jenë në përputhje me moshën dhe konceptet muzikore që zhvillohen në këtë klasë.

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i muzikës synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe në kontekstin shkollor. Në thelb, ky program përqendrohet në edukimin dhe formimin kulturor të nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, zbatuar dhe interpretuar njohuritë muzikore në mënyrë sa më të drejtë dhe të bukur në jetën e tyre të përditshme. Programi i lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të lartë përmban:

- a) *Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënësve që zhvillohen nëpërmjet lëndës së muzikës.* Lënda e muzikës kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e kompetencave kyçe si dhe aftësive të shekullit 21-të si: të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve, aftësitë qytetare, aftësitë digjitale etj. *Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së muzikës.* Programi i muzikës ndërthur njohuritë dhe aftësitë e saj me temat ndërkurrikulare si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik dhe siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media duke i lidhur konceptet muzikore me situata konkrete që nxënësit përballen në jetën e tyre.
- b) *Kompetencat e lëndës së muzikës dhe rezultatet e të nxënësve.* Muzika nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit 21. Ai e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit 21, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e muzikës, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.

Diagrama 1. Përmbajtja e programi lëndor të muzikës



- c) *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënësve.* Në këtë rubrikë përshkruhet koha e dedikuar (numri i orëve mësimore) të klasës së dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë për çdo tematikë, duke ofruar hapësirë për punë individuale, në grup etj; tematikat e lëndës dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre; njohuritë kryesore, aftësitë për secilën tematikë dhe qëndrimet që demonstroi nxënësi.
- d) *Metodologjia e mësimdhënies.* Në lëndën e muzikës është e rëndësishme t'i kushtohet një vëmendje e madhe përdorimit të metodave interaktive, teknikave të menduarit kritik dhe krijues, bashkëpunimit në ansamble kor/ instrumente. Përshkrimi i mësimimit për nxënësit me nevojë të veçanta dhe mbështetja e talenteve në lëndën e muzikës është kurioziteti për lëndën. Në këtë rubrikë do të ketë edhe disa shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve.
- e) *Vlerësimi i nxënësve është një tjetër rubrikë,* e cila përshkruan në mënyrë të përmbledhur llojet e vlerësimit të nxënësve, shembuj të instrumenteve të vlerësimit, vlerësimi si metodologji të nxënësve. Gjithashtu në këtë rubrikë do të ketë edhe shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënësve.
- f) *Burimet dhe materialet didaktike* që mund të përdoren në lëndën e muzikës. Njohja me konceptet muzikore, instrumentet muzikore dhe vepra të ndryshme muzikore të sjella nga burime të ndryshme dhe materiale didaktike të demonstruara me mjete konkrete.
- g) *Rekomandime për zbatimin e programit.* Në këtë rubrikë do të ketë disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor siç janë: nxënësit, mësuesit, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit.
- h) *Ndryshimet përmbajtjesore.* Në këtë rubrikë do të përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen lëndore.

4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E MUZIKËS

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës, sipas klasave të arsimit të mesëm të lartë. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive. Muzika nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit 21. Ajo e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv* dhe *qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit 21, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e muzikës, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.

- **Kreativiteti**, muzika inkurajon dhe nxit krijimtarinë përmes kompozimit, improvizimit dhe interpretimit artistik. Nxënësit mësojnë të shprehin veten në mënyrë unike dhe të zhvillojnë ide origjinale.
- **Bashkëpunimi**, muzika nxit nxënësit të punojnë në grup si p.sh.: në kor, në ansambël, ku secili ka një rol të rëndësishëm. Kështu ju jepet mundësia që ata të punojnë në grup, të zhvillojnë dëgjim aktiv dhe të ndajnë dhe kuptojnë përgjegjësitë.
- **Komunikimi**, muzika si një formë universale komunikimi – përçon ndjenja, mesazhe dhe histori. Gjithashtu, diskutimi mbi muzikën ndihmon zhvillimin e të folurit dhe të shkruarit.
- **Mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve**, muzika inkurajon dhe nxit nxënësit në analizimin e veprave muzikore, zhvillon aftësitë e vendimmarrjes gjatë interpretimit dhe ndihmojnë në zhvillimin e mendimit analitik.
- **Aftësitë teknologjike**, muzika inkurajon dhe nxit përdorimin e softuerëve muzikorë, platformat online për krijim/shpërndarje të informacionit muzikor duke zhvilluar aftësitë digjitale.

- **Ndërgjegjësimi global dhe kompetencat kulturore**, muzika jep mundësinë për njohjen dhe kuptimin e kulturave të ndryshme në klasë. Mësimi i muzikës i ndihmon nxënësit të jenë më të hapur dhe të kuptojnë diversitetin kulturor.
- **Aftësitë për mësim gjatë gjithë jetës**, muzika kërkon përkushtim, durim dhe disiplinë – vlera që ndihmojnë në formimin e një qëndrimi pozitiv ndaj të nxënit të vazhdueshëm.

Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballë me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca e zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke u vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që duhet të zhvillojë nxënësi në klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë në lëndën e muzikës mund të përmbliidhen si më poshtë:

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - komunikon në mënyrë efektive si dëgjues, folës, lexues dhe shkruar; - përshtat komunikimin me situatat dhe qëllimet e muzikës; - kërkon, mbledh dhe përpunon informacione mbi muzikë, përfaqësuesit dhe veprat muzikore me mjete ndihmëse; - formulon dhe shpreh argumente në gojë dhe shkrim ndaj muzikës apo ngjarjeve të ndryshme muzikore; 	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - fillon, ndjek dhe përfundon biseda të thjeshta për tema të ndryshme muzikore; - përdor mjetet dhe angazhohet në komunikim joformal mbi muzikën;

<ul style="list-style-type: none"> - merr pjesë në biseda për tema muzikore; - transmeton saktë të dhënat muzikore të mbledhura në forma të ndryshme; - prezanton projekte muzikore përmes komunikimit verbal dhe elektronik; - formulon analiza të thelluara mbi tekstet dhe mesazhet muzikore; - shpreh opinion kritik mbi interpretime ose stile muzikore; - komunikon qartë në shkrim dhe me gojë gjatë prezantimeve muzikore; - identifikon burime informacioni për orientim profesional dhe zhvillon një plan karriere . 	<ul style="list-style-type: none"> - merr pjesë në biseda me tema muzikore, duke bërë pyetje dhe dhënë përgjigje; - transmeton saktë informacion mbi muzikën në formë të ndryshme; - prezanton një projekt me temë mbi muzikën duke përdorur komunikimin verbal dhe elektronik; - kupton dhe interpreton tekste muzikore të ndërlikuara në gjuhë të huaja; - komunikon për përmbajtje muzikore në një gjuhë të dytë; - përdor gjuhën e huaj për të kërkuar, përshkruar ose prezantuar projekte artistike.
<p>Kompetenca në STEM (matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri)</p>	<p>Kompetenca digjitale</p>
<p><i>Për të dëshmuar kompetencat në STEM nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton parime dhe procese muzikore në jetën e përditshme, përfshirë aftësitë kompozicionale, të këndimit, analizës, kërkimit etj.; - aplikohet njohuria mbi tingullin, akustikën dhe strukturat për të krijuar vepra muzikore; 	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor programe muzikore për kompozim, miksime ose montazh; - Harton prezantime multimediale mbi histori, stile apo artistë të veçantë;

<ul style="list-style-type: none"> - përdor instrumente ose pajisje digjitale për të prodhuar ose analizuar muzikën; - lidhet me fenomene natyrore dhe teknologjike me artin muzikor; - njeh karakteristikat e kërkimit shkencor dhe komunikon përfundimet; - shfrytëzon burime të ndryshme për zhvillimin e ideve dhe projekteve; - parashtron pyetje dhe organizon mendimet për zgjidhjen e problemeve; - prezanton idetë për zhvillimin e aktiviteteve muzikore dhe argumenton ato; - përdor informacionin për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve duke argumentuar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Menaxhon përmbajtje artistike në platformat online me etikë dhe kreativitet; - identifikon dhe zgjidh probleme mbi muzikën, duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale; - përdor inteligjencën artificiale për të analizuar dhe interpretuar të dhëna muzikore apo dhe për të zgjidhur problem; - bashkëpunon me moshatarët duke përdorur teknologjinë për zgjidhjen e problemeve në muzikë; - përdor mendimin kritik për të planifikuar projekte të ndryshme muzikore.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit	Kompetenca qytetare
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon stilin personal të të mësuarit përmes përvojave muzikore; - planifikon objektiva për zhvillimin e vetëdijshëm artistik dhe emocional; - reflekton për rolin e muzikës në rritjen e vetes dhe të të tjerëve; 	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon solidaritet në zgjidhjen e problemeve në shkollë, komunitet e më gjerë; - vlerëson diversitetin kulturor me tolerancë dhe respekt; - demonstroi vlerat e të drejtave të njeriut, si respekti për dinjitetin personal dhe lufta kundër diskriminimit;

<ul style="list-style-type: none"> - identifikon dhe përmirëson përparësitë dhe dobësitë personale lidhur me muzikën; - organizon, fokusohet në të nxënit, vendos qëllime dhe vlerëson punën e tij; - motivon dhe vlerëson veten, punon në mënyrë të pavarur dhe në grup në procese të ndryshme muzikore; - shpreh dëshirë për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe bashkëpunon në mënyrë konstruktive; - analizon dhe zgjidh probleme emocionale dhe sociale, duke propozuar alternativa pozitive. 	<ul style="list-style-type: none"> - inkuadrohet në grupe muzikore që shërbejnë komunitetin; - identifikon dhe reflekton mbi çështje sociale përmes krijimit muzikor; - merr pjesë në projekte që promovojnë kulturën kombëtare dhe dialogun ndërkulturor. - menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive dhe paanshme; - reagon ndaj shkeljeve të të drejtave të të tjerëve dhe diskuton pasojat e këtyre veprimeve.
<p>Kompetenca e sipërmarrjes</p>	<p>Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore</p>
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor imagjinatën për procese krijuese dhe novatore në muzikë; - planifikon projekte muzikore dhe i organizon proceset deri në përfundim; - organizon ngjarje muzikore me përgjegjësi buxhetore dhe logjistike; - tregon lidhshmëri në ndarjen e roleve dhe në menaxhimin e burimeve artistike; 	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - shpreh dhe interpreton emocionet dhe idetë e tij me art dhe forma të tjera kulturore; - shpreh veten në media të ndryshme, duke përmirësuar kapacitetin personal; - identifikon mundësi për të shprehur vlera personale, sociale nëpërmjet arteve;

<ul style="list-style-type: none"> - përdor aftësi kreative për të zhvilluar ide muzikore dhe projekte novatore; - punon në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunon me të tjerët; - vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit; - ndërmerri aktivitete për zgjidhjen e problemeve shoqërore (ekspozita, fushata, etj.); - analizon pasojat e dëmtimit të mjedisit dhe organizon aktivitete për mbrojtjen e tij; - përdor materiale dhe teknologjinë për avancim në mësim dhe orientim në karrierë. 	<ul style="list-style-type: none"> - zbulon identitetin përmes analizës dhe krijimit muzikor; - vlerëson trashëgiminë muzikore si pjesë e ndërtimit të një kulture personale dhe kolektive; - eksperimenton me forma të ndryshme muzikore për të shprehur mendim artistik; - angazhohet në procese krijuese, si individualisht ashtu dhe kolektivisht.
---	--

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e muzikës²

Integrimi i temave ndërkurrikulare me muzikën në arsimin e mesëm të lartë u mundëson nxënësve të kuptojnë më thellë lidhjet ndërmjet muzikës dhe jetës reale, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi analitike, mendim kritik, argumentim dhe zgjidhje problemesh. Këto tema përforcojnë përdorimin e muzikës si mjet për interpretimin e të dhënave, planifikimin, marrjen e vendimeve dhe vlerësimin e situatave të ndryshme shoqërore, kulturore dhe shkencore.

- *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.* Muzika i ofron mundësinë nxënësit për zhvillimin e ndjenjës së *identitetit kombëtar, njohjes dhe respektit ndaj kulturave të ndryshme.* Përmes zhvillimit të kësaj teme lënda e muzikës kërkon të zhvillojë ndjenjën e identitetit kombëtar përmes njohjes dhe këndimit të këngëve popullore shqiptare duke zbuluar traditat, zakonet, veshjet dhe historinë e vendit. Njohjes së instrumenteve tradicionale (si lahuta, çiftelia, fyelli, dajreje etj.) duke rritur krenarinë kombëtare. Interpretimit të këngëve dhe valleve popullore nga zona të ndryshme të Shqipërisë. Gjithashtu muzika ofron mundësinë që nxënësi të njohë kultura të tjera si: Këngë, valle dhe instrumente nga kultura të ndryshme (të rajonit dhe përtej) duke kuptuar dhe respektuar larminë kulturore. Kjo tematikë mundëson organizimin e aktiviteteve muzikore- kulturore si: “Trashëgimia jonë kulturore”, “Java Ndërkulturore”, etj., ku mund të prezantohen tradita dhe kultura të ndryshme përmes muzikës dhe vallëzimit.
- *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.* Në këtë temë, muzika luan rol kyç sepse krijon mundësi që nxënësi të mësojë jo vetëm për artin, por edhe për rolin e tyre si qytetarë të angazhuar dhe krijues në komunitet. Duke qenë se muzika ka qenë gjithmonë një formë shprehjeje për çështje sociale, politike dhe komunitare, nxënësi analizon këngë që përcjellin mesazhe të drejta qytetare, si: promovimi i paqes, të drejtat

² Veprimtaritë praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare mund të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë - muzika.

e njeriut, barazinë apo mbrojtjen e mjedisit etj. Nxënësi krijon vetë *këngë që përçojnë mesazhe sociale*, duke u angazhuar në diskutime dhe reflektime mbi realitetin e tyre. Për realizimin e kësaj tematike mund të realizohen *koncerte që përcjellin një mesazh*, (p.sh. ndihmë për fëmijë në nevojë, mbledhje fondesh për një çështje komunitare etj.).Ndërsa në lidhje me sipërmarrjen mund të trajtohen tema si: *si të menaxhosh një grup muzikor, një koncert apo një kanal muzikor online*. Tema të tjera p.sh.: si funksionon industria muzikore – nga prodhimi i muzikës, marketingu, promovimi, deri te shitja, apo *roli i rrjeteve sociale* në zhvillimin e një karriere muzikore ose krijimin e projekteve muzikore fitimprurëse.

➤ *Shëndeti mendor, fizik dhe siguria*. Muzika krijon mundësi të mira për të edukuar nxënësin por edhe duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien emocionale, fizike dhe sociale të tyre. Ajo luan një rol të rëndësishëm në jetën tonë të përditshme dhe shpesh përdoret për të reduktuar stresin, ankthin si dhe për të përmirësuar gjendjen shpirtërore. Nxënësi dëgjon dhe analizon rreth një muzike relaksuese; krijon një playlist muzikor personal, me muzikë që zhvillon ndjenjën e qetësisë/qeta, energjisë/ritmike, përqendrim; krijon ose interpreton këngë që shprehin emocione, duke nxitur vetëdijën emocionale. Gjithashtu, muzika është e lidhur ngushtë me **aktivitetin fizik**, sidomos përmes vallëzimit dhe lëvizjes. Ajo edukon nxënësin me sigurinë se si:

- të sillet dhe rregullat që duhet të ndjekë **në aktivitete muzikore** (si prova, koncerte, përdorimi i instrumenteve).
- të ruaj veten por edhe të tjerët, duke përdorur muzikën në mënyrë të shëndetshme gjatë dëgjimit dhe mbrojtur nga dëgjimi i muzikës me volum të lartë.
- të diskutojë dhe ndajë nëpërmjet internetit krijimet e veta muzikore duke ruajtur të drejtat e autorit.

➤ *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore*. Në lëndën e muzikës zhvillohet në mënyra kreative dhe edukative si: krijimi i këngëve me tekste poetike që flasin për: ruajtjen e natyrës, ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, ndryshimet klimatike, rëndësinë e riciklimit dhe kursimit të energjisë

Analizimi i këngëve ekzistuese me temë mjedisore ku mund të analizohet përmbajtja dhe mesazhi i këngëve të njohura që trajtojnë çështje të mjedisit. Organizimi i një koncerti tematik ku të interpretohen këngë me temë mjedisore, duke kombinuar njohuritë e muzikës me artin pamor dhe mesazhe për ruajtjen e mjedisit.

➤ *Teknologjia, shoqëria dhe media.* Muzika luan një rol të rëndësishëm për të zhvilluar te nxënësit aftësi kritike, kreative dhe digjitale në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur përmes teknologjisë. Teknologjia ka transformuar mënyrën se si krijohet, regjistrohet dhe shpërndahet muzika. Nxënësi mëson të përdorë programe të ndryshme muzikore digjitale (si GarageBand, Soundtrap, Audacity), krijon kompozime origjinale përmes teknologjisë, analizon si janë krijuar këngë moderne me ndihmën e teknologjisë (efekte, sintetike, miksimet etj.). Gjithashtu media ndikon në shijet muzikore, ndërsa përdorimi i mediave sociale dhe platformat online (YouTube, TikTok, Spotify) ndikojnë në formimin e preferencave muzikore dhe identitetit kulturor të të rinjve.

Muzika është një gjuhë universale që lidh njerëzit në komunitete online dhe reale. Nxënësi krijon projekte multimediale muzikore për të trajtuar çështje sociale (si bullizmi, barazia gjinore, miqësia), organizon një fushatë online me një këngë me mesazh shoqëror, reflekton mbi etikën e përdorimit të muzikës në rrjete sociale (e drejta e autorit, privatësia).

4.3 Kompetencat e lëndës “Muzikë” dhe aftësitë e shekullit XXI që zhvillohen përmes saj

Muzika nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit 21. Ajo e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit 21, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e muzikës, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.


- **Kreativiteti**, muzika inkurajon dhe nxit krijimtarinë përmes kompozimit, improvizimit dhe interpretimit artistik. Nxënësit mësojnë të shprehin veten në mënyrë unike dhe të zhvillojnë ide origjinale.
- **Bashkëpunimi**, muzika nxit nxënësit të punojnë në grup si p.sh.: në kor, në ansambël, ku secili ka një rol të rëndësishëm. Kështu ju jepet mundësia që ata të punojnë në grup, të zhvillojnë dëgjim aktiv dhe të ndajnë dhe kuptojnë përgjegjësitë.

- **Komunikimi**, muzika si një formë universale komunikimi – përçon ndjenja, mesazhe dhe histori. Gjithashtu, diskutimi mbi muzikën ndihmon zhvillimin e të folurit dhe të shkruarit.
- **Mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve**, muzika inkurajon dhe nxit nxënësit në analizimin e veprave muzikore, zhvillon aftësitë e vendimmarrjes gjatë interpretimit dhe zgjidhja e sfidave teknike ndihmojnë në zhvillimin e mendimit analitik.
- **Aftësitë teknologjike**, muzika inkurajon dhe nxit përdorimin e softuerëve muzikorë, platformat online për krijim/shpërndarje të informacionit muzikor duke zhvilluar aftësitë digjitale.
- **Ndërgjegjësimi global dhe kompetencat kulturore**, muzika jep mundësinë njohjen dhe kuptimin e kulturave të ndryshme në klasë. Mësimi i muzikës i ndihmon nxënësit të jenë më të hapur dhe të kuptojnë diversitetin kulturor.
- **Aftësitë për mësim gjatë gjithë jetës**, muzika kërkon përkushtim, durim dhe disiplinë – vlera që ndihmojnë në formimin e një qëndrimi pozitiv ndaj të nxënit të vazhdueshëm.

4.4 Kompetencat e lëndës së muzikës dhe rezultatet e të nxënit

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e muzikës synon të përmbushë 3 kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore. Këto kompetenca zbërthehen në rezultate të nxëni për secilën klasë.

Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së muzikës



Gjithashtu lënda e muzikës, zhvillon një sërë aftësish ku nxënësit angazhohen në aktivitetet muzikore dhe zhvillojnë kompetencat muzikore.

Tre janë kompetencat lëndore të muzikës që përftohen nga njohuritë dhe përfshijnë:

Tabela 2: Kompetencat muzikore dhe rezultatet e të nxënësve

KOMPETENCAT LËNDORE - MUZIKË		
Kompetencat lëndore	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënësve për kompetencat për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë
Krijimi muzikor	<p><i>Nxënësi zhvillon aftësitë krijuese duke zbuluar përmes gjuhës së muzikës dhe duke e komunikuar atë përmes një shumëllojshmërie të krijimeve të veta.</i></p> <p><i>Kjo kompetencë kërkon që nxënësit të zhvillojnë ide të reja krijuese, duke i ndarë ato me shokët e klasës, në shkollë, komunitet por edhe në ngjarje të ndryshme artistike.</i></p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdor ide të ndryshme për të organizuar mendimin e tij personal estetik muzikor. - Zhvillon mendimin e tij personal mbi elementet muzikor gjatë analizimit të veprës muzikore. - Shpreh përjetimet dhe përfytyrimet muzikore gjatë dëgjimit muzikor. - Organizon njohuritë e veta për të shprehur mesazhin e veprës muzikore.

	<p><i>Në përgjithësi, kompetenca e krijimit është thelbësore për suksesin në muzikë, pasi u mundëson individëve të kuptojnë gjuhën muzikore dhe ta zhvillojnë atë më tej, drejt promovimit të ideve të reja edhe në muzikë.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - respekton idetë dhe punën shokëve, duke kontribuar në ide dhe zgjidhje të reja. - ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.
<p>Interpretimi muzikor</p>	<p><i>Nxënësi përmes kësaj kompetence zhvillon aftësinë për të interpretuar këngë dhe për të luajtur në instrumente të thjeshta muzikore si bllok flaut, tastierë etj. Nxënësi interpreton me ndjenjë dhe emocione duke zbatuar kërkesat e një interpretimi korrekt në ritëm dhe intonacion, muzikalitet dhe emocion.</i></p>	<p style="text-align: center;">Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zbaton teknika dhe procese të ndryshme muzikore gjatë këndimit dhe luajtjes me instrumente. - Performon dhe interpreton emocionalisht gjatë procesit të këndimit këngë korale dhe të rrymave të ndryshme moderne, kanone, këngë popullore, etj., duke zhvilluar një kuptim të qartë të këndimit vetëm dhe në grup. - Përjeton emocionalisht gjatë procesit të dëgjimit, vepra të ndryshme muzikore (vokale apo instrumentale), duke zhvilluar një kuptim të qartë të veprës muzikore. - Këndon motive apo tema mjaft të njohura të pjesëve muzikore apo melodive të përzgjedhura (rinjohje nëpërmjet fishkëllimit apo këndimit të temave kryesore).

		<ul style="list-style-type: none"> - Jep gjykimin dhe mendimin e vet mbi përmbajtjet muzikore parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të tyre(ese-ja). - Ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë.
<p>Vlerësimi i veprave muzikore</p>	<p><i>Nxënësi përmes kësaj kompetence zhvillon aftësinë për të dëgjuar, përjetuar, përshkruar emocionet nga fragmente nga vepra muzikore të përzgjedhura për këtë grup moshë. Nxënësi zhvillon aftësitë e të menduarit kritik duke përdorur aftësitë kërkuese, analizuese dhe gjykuese ndaj veprave muzikore pavarësisht llojit të zhanrit, stilit apo kompozitorit. Vlerëson veprat muzikore, sipas gjinisë, llojit, autorit , vendit dhe periudhës historike në të cilën është realizuar vepra, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.</i></p> <p><i>Gjithashtu, ai bashkëpunon dhe komunikon rreth muzikës që dëgjon, duke vlerësuar në</i></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon më tej aftësitë për të dëgjuar dhe analizuar muzikën kombëtare dhe botërore. - Njeh vepra muzikore nga përfaqësuesit e tyre nga kultura të ndryshme. - Kupton ndikimin e muzikës nga kontekste të ndryshme kulturore. - Shkëmben ide dhe përvoja muzikore me bashkëmoshatarët. - Ofron dhe pranon këndvështrime mbi lloje apo performanca të ndryshme muzikore. - Zhvillon gjykimin e vet muzikor dhe estetik mbi veprat të ndryshme muzikore. - Analizon veprat muzikore (vokale dhe instrumentale), duke u mbështetur veçoritë e veprave muzikore.

	<p><i>mënyrë kritike por edhe duke pranuar këndvështrimin ndryshe.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bën krahasimin midis dy veprave muzikore, duke u shprehur me një gjuhë të qartë muzikore dhe përdorur terminologji të qartë muzikore. - Vlerëson veprat muzikore, sipas llojit muzikor, autorit, vendit dhe periudhës historike në të cilën është realizuar vepra, duke ndërtuar një gjykim kritik dhe estetik.
--	--	--

5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë

Lënda e muzikës zhvillohet për 36 javë mësimore me nga 2 orë, pra gjithsej 72 orë. Lënda e muzikës specifikon kohën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë, kurrikula me zgjedhje të detyruar. Kjo ka si qëllim që, përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

Tematika	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknika dhe procese	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa 10/11/12	15	30	27	72 orë

5.2 Përmbajtja e lëndës sipas tematikave dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre

Programi i lëndës muzikë klasa e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë zhvillohet përmes tri tematikave:

Tematika I: Gjuha dhe komunikimi muzikor,

Tematika II: Teknika dhe procese muzikore,

Tematika III: Historia, muzika dhe shoqëria.

Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë, që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse, ndërkohë qëndrimet dhe vlerat që demonstroi nxënësi në lëndë e muzikës përmbledhen për të gjitha tematikat. Tematikat dhe renditja e tyre **nuk** presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

5.2.1 Tematikat: Gjuha dhe komunikimi – Teknika dhe procese – Historia, muzika dhe shoqëria

TEMATIKA: GJUHA DHE KOMUNIKIMI	
<p><i>Përshkrimi i tematikës</i></p> <p>Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që muzika dhe shumë çështje të saj trajtohen përmes studimit të gjuhës muzikore. Kuptimi dhe shpjegimi i gjuhës muzikore tashmë bëhet jo vetëm nëpërmjet elementeve dhe parimeve të formësimit muzikor, por edhe nëpërmjet kuptimit dhe shpjegimit emocional të veprës, e cila zhvillon mendimin personal të nxënësit për të kuptuar të bukurën në muzikë. Gjatë dëgjimit muzikor sipas formave të interpretimit vokal apo instrumental, nxënësi kupton se muzika është e organizuar sipas formës dhe përmbajtjes. Duke i përjetuar veprat e ndryshme muzikore nëpërmjet dëgjimit, nxënësi fillon të kuptojë nga njëra anë muzikën me tipare “thjesht muzikore” dhe, nga ana tjetër, muzikën si pjesë e strukturave sintetike të artit, e përzier me letërsinë, teatrin, baletin etj. Muzika është një veprimtari tërësisht humane dhe duke qenë kështu, ajo i përket njeriut dhe botës së tij. Nga ana tjetër, ashtu si vetë njeriu, ajo mund të shfaqet në mënyra të ndryshme dhe secila prej tyre sjell në vetvete diçka origjinale.</p>	
NJOHURITË	AFTËSITË
<p>Gjuha, mendimi dhe komunikimi muzikor:</p> <p>Muzika dhe funksionet e saj.</p>	<p><i>Nxënësi demonstroi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - formulon ide dhe përkufizime të ndryshme rreth artit muzikor; - shpjegon funksionet e muzikës përgjatë zhvillimit të historisë së njerëzimit;

	<ul style="list-style-type: none"> - diskuton rreth veçorive apo karakteristikave, që e bëjnë një krijim muzikor të bukur.
<p>Elementet dhe parimet muzikore:</p> <p>- Melodia, ritmi, harmonia.</p>	<p><i>Nxënësi demonstroi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon rolin e mjeteve shprehëse muzikore, bazë në kuptimin dhe realizimin e një vepre muzikore; - përshkruan dhe diskuton mbi ndryshueshmërinë e emocionit që krijojnë elementet muzikore në një vepër.
<p>Format muzikore</p>	<p><i>Nxënësi demonstroi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon parimet e formësimit të muzikës dhe strukturën muzikore të ndërtimit të një vepre muzikore (formë - përmbajtje); - shpjegon format muzikore njëpjesëshe, dypjesëshe dhe tre pjesësh dhe polifonike. - bën dallimin e formave muzikore njëpjesëshe, dypjesëshe, tre pjesësh vokale dhe instrumentale dhe polifonike gjatë dëgjimit muzikor. - Argumenton gjykimin e tij ndaj veprave muzikore vokale apo instrumentale, pavarësisht formës muzikore.

TEMATIKA: TEKNIKA DHE PROCES

Përshkrimi i tematikës

Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që nxënësi të aftësohet në procesin e këndimit, proces i cili ka kaluar nëpër një rrugëtim të gjatë në zhvillimin dhe perfeksionimin teknik të tij, deri tek të kënduarit e sotëm. Kështu nga këndimi njëzërësh dhe më pas ai shumëzërësh, filluan të krijohen forma dhe gjini të ndryshme muzikore vokale. Interpretimi vokal i pjesëve të sugjeruara janë rrugëtimi i të kënduarit vokal solo dhe në kor, klasike dhe moderne. Pjesët muzikore vokale dhe këngët e rrymave të ndryshme muzikore do të jenë pjesë e mësimimit dhe interpretimit vokal të kësaj tematike.

NJOHURITË	AFTËSITË
Këndimi vetëm/ solo	<p><i>Nxënësi demonstron se:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- njih dhe respekton rregullat e këndimit vetëm dhe në grup;- njih ndërtimin dhe formacionin e plotë të korit, sipas mënyrës së vendosjes së një kori, pozicionin e koristit në mënyrën e vendosjes në kor dhe të të qëndruarit gjatë këndimit;- provon të këndojë vetëm dhe me të tjerë, duke kuptuar ndryshueshmërinë e zërit dhe ngjyrimin e tij nga të tjerët;- dëgjon dhe komenton gjendjen emocionale që krijohet nëpërmjet timbrit të zërit të këngëtarëve me vokal të ndryshëm;- njih përmbajtjen poetike dhe melodike të pjesëve vokale muzikore,

	- faktor për një interpretim dhe realizim më të mirë artistik dhe shprehës.
Këndimi në grup/ kor	<p><i>Nxënësi demonstroi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Këndon në intonacion të pastër dhe ritmin e këngës/korales. ○ J.S.Bach-Gounod - “Ave Maria” ○ J. Brahms - “Në qetësinë e natës”; “Nina-nana” ○ R. Schuman - Nina nana ○ L.V. Bethoven - “Oda e gëzimit” – koralja, simfonia 9-të ○ S. Gjoni - “Lule Borë” ○ R. Dhomi - “O moj e Bukura More” <ul style="list-style-type: none"> - Interpreton këngë të rrymave të ndryshme moderne. - Interpreton mjuzikëll të ndryshëm.

TEMATIKA: HISTORIA, MUZIKA DHE SHOQËRIA

Përshkrimi i tematikës

Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që nxënësi të aftësohet më tej në njohjen e kulturës muzikore dhe zhvillimit të saj, sipas karakteristikave të periudhës, veprave dhe kompozitorëve, merr përsipër të studiojë zhvillimin e muzikës nga fillimet e saj deri në ditë tona. Kultura muzikore dhe zhvillimi i saj sipas karakteristikave dhe konteksteve historike, sociale dhe kulturore në të cilat ato janë zhvilluar merr përsipër të studiojë zhvillimin e saj të veprave dhe kompozitorëve, nga Antikiteti e deri në ditët tona përmes disa periudhave. Periudha e Mesjetës na njeh me korin

gregorian, muzikën polifonike, instrumentet muzikore, jetën dhe veprat e kompozitorëve të kësaj periudhe. Ajo vazhdon më tej me zhvillimin e muzikës në periudhën e Rilindjes, si dhe me zhvillimin e formave të para muzikore të krijuara gjatë kësaj periudhe, muzikën në periudhën Barok, Klasicizëm, Romantizëm dhe shekulli 20-të dhe rrymave të ndryshme moderne (xhaz, rok, etj). Gjithashtu, kjo tematikë mundëson njohjen dhe studimin me zhvillimin e muzikës shqiptare përmes jetës dhe veprave të kompozitorëve të këtyre periudhave.

Përjetimi dhe të shprehurit përmes dëgjimit muzikor është një proces shumë i rëndësishëm në muzikë, i cili nuk mund të zhvillohet pa njohur shumë mirë si u krijua dhe u zhvillua kjo lloj muzike në periudha të caktuara, ndikimet dhe karakteristikat që patën veprat muzikore nga koha në të cilën u krijuan. Karakteristikat e periudhës, veprat e kompozuar dhe kompozitorët do të vijnë thjeshtë dhe natyrshëm përmes njohurive paraprake të nxënësve, dëgjimit dhe përjetimit konkret të veprave muzikore, përmes diskutimeve dhe interpretimit të mendimit muzikor apo prezantimeve individuale dhe në grup (projekteve) të periudhave të marra në studim.

NJOHURITË	AFTËSITË
<p>Kultura muzikore dhe zhvillimi i saj, sipas karakteristikave të periudhës, veprave dhe kompozitorëve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kultura muzikore në Antikitët - Kultura muzikore në Mesjetë - Kultura muzikore në periudhën e Rilindjes - Kultura muzikore në periudhën Barok 	<p><i>Nxënësi demonstroi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Hulumton dhe analizon rrugën që ka ndjekur zhvillimi i kulturës muzikore në periudha të ndryshme. - Shpjegon karakteristikat <i>historike, politike, gjeografike, kulturore, fetare</i> që ndikuan në zhvillimin e kulturës muzikore në periudha të ndryshme. - Kupton përmes dëgjimit <i>format e ndryshme muzikore</i> vokale dhe instrumentale. - Kërkon të dhëna dhe krahason dy vepra të të njëjtës formë muzikore me autorë të ndryshëm, duke argumentuar veçoritë e veprës vet.

- Zhvillimi i muzikës në periudhën e Klasicizmit
- Zhvillimi i muzikës në periudhën e Romantizmit
- Zhvillimi i muzikës në periudhën Barok

- Përzgjedh dy forma muzikore, vokale apo instrumentale dhe shpjegon karakteristikat dhe veçoritë e tyre.
- Vlerëson veprat muzikore, sipas llojit, autorit, vendit dhe periudhës historike në të cilën është realizuar vepra, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.
- Shpreh nëpërmjet ese-së emocionet që i krijon vepra muzikore.
- Prezanton informacionin e mbledhur rreth zhvillimit muzikor për çështje specifike gjatë këtyre periudhave të marra në studim, në ppt.
- Realizon një projekt ndër lëndor, mbi jetën dhe veprën e një kompozitori apo grupi kompozitorësh të një periudhe të caktuar.
- Krijon CD me pjesët më të zgjedhura e të preferuara nga vepra të ndryshme muzikore klasike apo modern.
- Prezanton informacionin e mbledhur rreth *muzikës* gjatë këtyre periudhave të marra në studim.
- Realizon një projekt mbi jetën dhe veprën e një kompozitori apo grupi kompozitorësh të një periudhe të caktuar.
- Krijon CD me pjesët më të zgjedhura e të preferuara nga vepra të ndryshme muzikore.
- Përdor mjete të ndryshme të teknologjisë për:
 - kërkim të dhënash,
 - prezantim,

- regjistrime audio dhe video.

QËNDRIME DHE VLERA

Nxënësi:

- Zhvillon qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit të muzikës duke nxitur kureshtjen, dëshirën për të zbuluar dhe eksploruar vepra të reja muzikore, zhanre dhe stile.
- Krijon vetëbesim dhe vetëvlerësim duke i bërë ata të ndihen të sigurt për aftësitë e tyre muzikore.
- Zhvillon durimin dhe përqendrimin, vëmendjen dhe këmbënguljen për mësimin e instrumenteve muzikore.
- Zhvillon disiplinë dhe respekt ndaj rregullave të mësimin të muzikës në grup.
- Përfshihet aktivisht dhe mëson të marrë pjesë me dëshirë në veprimtaritë krijuese dhe bashkëpunuese në klasë dhe në shkollë.
- Krijon ndjenjën e bashkëpunimit dhe punës në grup ku muzika shpesh realizohet në ansamble, duke nxitur ndjesinë e përkatësisë dhe përgjegjësisë kolektive.
- Stimulon imagjinatën për të shprehur ndjenjat në mënyrë artistike përmes krijimeve muzikore.
- Ndan kuptimin dhe emocionet duke zhvilluar ndjeshmërinë dhe empatinë me të tjerët.
- Njeh kultura të ndryshme përmes muzikës, duke respektuar tradita të ndryshme muzikore dhe diversitetin kulturor.
- Praktikohet në mënyrë të rregullt për të krijuar një vetë disiplinë dhe përkushtim, duke kuptuar rëndësinë e përpjekjes dhe ushtrimit të vazhdueshëm.

5.3 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve)³.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi për përmbushjen e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.

Tabela 4. Shembull i veprimtarive për përmbushjen e RN-ve

REZULTAT TË NXËNI TË ORËS MËSIMORE	VEPRIMTARIA PRAKTIKE
SHEMBULLI	
<p>Shpjegon kontestin <i>historik, politik, gjeografik, kulturor, fetar</i> që ndikuan në zhvillimin e kulturës muzikore në periudhën e Klasicizmit.</p>	<p>Prezantimi i situatës Mësuesi prezanton situatën problemore me ndihmën e një videoje të shkurtër ose imazhi historik nga Revolucioni Francez + një fragment nga një vepër e Mozart ose Haydn. Bën pyetje të hapura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë lidhje mund të ketë kjo muzikë me atë që ndodhte në Evropë? - A mund të jetë muzika një pasqyrë e kohës?

³ Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e muzikës do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit sipas tematikave të lëndës.

Nxënësit ndahen në 3–4 grupe dhe secili trajton një aspekt:

- Historia dhe politika
- Feja dhe ndikimi në përmbajtje muzikore
- Gjeografia dhe qendrat kulturore
- Kultura dhe filozofia iluministe

Çdo grup mbledh të dhëna nga materiale të përgatitura nga mësuesi dhe krijon një **poster** ose **prezantim digjital** që tregon ndikimin e kontekstit të tyre në muzikën klasike.


Çdo grup prezanton punën e vet dhe nxënësit bëjnë pyetje. Mësuesi udhëheq një diskutim për të nxjerrë përfundimin:

“Muzika nuk lind në boshllëk. Ajo pasqyron kohën, vendin, idetë dhe ndjenjat e shoqërisë.”

Nxënësit shkruajnë:

- “Nëse do të isha kompozitor në atë kohë, për çfarë do të kompozjoja?”
- “A ka ndonjë artist sot që pasqyron realitetin politik apo shoqëror? Si?”

Diagrama 3. Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit



6 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv përfshin një kombinim qasjesh, strategjish, metodash dhe teknikash që përdoren për të mbështetur të nxënit efektiv dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve në mjediset mësimore. Këto strategji dhe metoda marrin parasysh dhe plotësojnë nevojat e të nxënit si dhe sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe shfrytëzimin e informacionit, duke nxitur përgjegjshmërinë vetjake, iniciativën, reflektimin, pavarësinë e gjykimit, vetëvlerësimin, bashkëpunimin dhe barazinë. Edukimi promovon disa metoda të nxëni të cilat janë: a) Të nxënit me në qendër nxënësin; b) Të nxënit që promovojnë kompetencat; c). të nxënit e diferencuar; d) të nxënit e integruar; dh) Përdorimi i teknologjisë digjitale; e) Mësimin e kombinuar; ë) Të nxënit e bazuar në projekte; f) Angazhimi aktiv; g) Zhvillimin e të menduarit kritik dhe zgjedhjes së problemeve; gj) Të nxënit në bashkëpunim; h) Të nxënit e bazuar në krijime etj.

6.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e muzikës.

Metoda mësimore në lëndën e muzikës janë:

Zhvillimi i ndjeshmërisë estetike dhe emocionale përmes përjetimit muzikor.

- *Nxënësit mësojnë të vlerësojnë bukurinë e muzikës dhe ndikimin e saj në ndjenjat dhe përjetimet personale.*

Formimi i kulturës muzikore përmes njohjes së stileve, zhanreve dhe traditave muzikore kombëtare e botërore.

- *Nxitja e vlerësimit për trashëgiminë muzikore shqiptare dhe të popujve të tjerë.*

Zhvillimi i aftësive për të dëgjuar, analizuar dhe interpretuar muzikë.

- *Përdorimi i dëgjimit të vetëdijshëm dhe analizës së thjeshtë për të kuptuar përbërësit e muzikës.*

Zhvillimi i aftësive për interpretim vokal dhe instrumental.

- *Këndimi në grup dhe individualisht; përdorimi i instrumenteve të thjeshta për të interpretuar ose shoqëruar muzikën.*

Nxitja e krijimtarisë muzikore dhe shprehjes personale përmes improvizimit dhe kompozimit.

- *Përfshirja e nxënësve në krijime të thjeshta muzikore, duke përdorur zërin, trupin apo instrumente.*

Forcimi i bashkëpunimit dhe komunikimit përmes aktiviteteve muzikore në grup.

- *Puna në ansamble vokale ose instrumentale që zhvillojnë frymën e grupit dhe përgjegjësinë e ndërsjellë.*

Përvetësimi i njohurive teorike bazë të muzikës.

- *Njohja e notacionit muzikor, ritmit, metrës, dinamikës dhe elementëve të tjerë të shprehjes muzikore.*

Ndërtimi i qëndrimeve pozitive ndaj mësimit të muzikës dhe përfshirjes në jetën kulturore.

- *Inkurajimi për pjesëmarrje në aktivitete artistike dhe vlerësimi i artit si pjesë e rëndësishme e jetës shoqërore.*

6.2 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e muzikës

Mësimi i muzikës për fëmijët *me nevoja të veçanta* kërkon strategji të veçanta të mësimdhënies dhe një qasje të personalizuar, të ndjeshme dhe të mbështetur në metoda fleksibël e kreative. Ja disa metoda mësimi të rekomanduara, të shoqëruara me strategji praktike që mund të zbatohen në klasë. Disa nga metodat dhe qasjet që mësuesi mund të zhvillojë në klasë për personat me nevoja të veçanta janë:

Metoda Orff (Carl Orff)

- › Përshkrimi: Bazohet në zhvillimin e një loje, improvizim, lëvizje dhe përdorimin e instrumenteve të thjeshta ritmike.
- › E përshtatshme: për të riun me spektrin e autizmit apo çrregullime të të nxënit.
- › Një model: I riu luan ritme të thjeshta me daulle ose përmes mjeteve trupore duke ndjekur një histori të treguar.

Metoda Kodály (Zoltán Kodály)

- › Përshkrimi: Përdor shumë këngë tradicionale, nota të thjeshta dhe sinjale dore.
- › E përshtatshme: për të riun me probleme me të folurit dhe të përqendrimit.
- › Një model: Mësuesi përdor gjeste për të ndihmuar nxënësin të dallojë tingujt muzikore dhe të këndojë.

Terapia Muzikore

- › Përshkrimi: Muzika përdoret për qëllime terapeutike – për të përmirësuar komunikimin, sjelljen dhe emocionet.
- › E përshtatshme: për fëmijë me spektrin e autizmit, ADHD, çrregullime emocionale.

- › Një model: Krijimi i një kënge personalizuese për të ndihmuar të riun të shprehë ndjenjat apo nevojat.

Ndërveprimi individual dhe i vogël në grup

- › Përshkrimi: Mësimi zhvillohet në grupe të vogla ose në mënyrë individuale.
- › E përshtatshme: sepse lehtëson ndjekjen e ritmit, duke respektuar vështirësitë e tij.
- › Një model: Puna në çifte për të improvizuar një dialog ritmik.

6.3 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e muzikës

Mësimi i muzikës për të riun *e talentuar* kërkon strategji të veçanta të mësimdhënies. Këto strategji kërkojnë nga mësuesi të përgatisë materiale të diferencuara për këta të rinj p.sh.: versione më të ndërlikuara të një këngë ose melodie. Numër më të madh të ushtrimeve në lidhje me ritmin dhe melodinë. Të nxisin të rinjtë e talentuar të krijojnë ose të dhe kompozojnë krijime të vogla muzikore. Ata inkurajojnë për të zhvilluar aftësitë analitike për të analizuar muzikë nga zhanre të ndryshme. Përmes dhënies së përgjegjesisë ata i vendosin këta nxënës në rolin e liderit p.sh.: rol udhëheqës në grup (si “dirigjent i klasës” në një lojë me instrumente apo këndim).

7 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në mësimin e muzikës, vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor dhe ndihmon mësuesin të kuptojë se sa mirë po i mësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Në lëndën e muzikës qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një note, por:

- t'i japë nxënësit mundësi të kuptojë progresin e tij, të mësojë nga gabimet duke reflektuar të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë, si dhe të motivohet për të ecur përpara;
- të ndihmojë mësuesin të kuptojë sa mirë nxënësit i kanë kuptuar koncepte dhe po i zbatojnë ato;
- të ndihmojë mësuesin të përmirësojë mënyrën e mësimdhënies;

7.1 Llojet e vlerësimit në lëndën e muzikës

Vlerësimi diagnostikues (vlerësimi si proces të nxëni)

Ky lloj vlerësimi bëhet në fillim të vitit shkollor. Mësuesi zbulon njohuritë që nxënësi ka dhe identifikon çfarë ka nevojë të përsëritet ose të mësohet më mirë. Ky vlerësim ndihmon mësuesin të planifikojë më mirë mësimin, duke përshtatur ritmin dhe mënyrat e punës me nevojat e nxënësve.

Ky vlerësim mund të realizohet:

- ✓ me pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta;
- ✓ me ushtrime të shkurtra orientuese;
- ✓ me kuice të shkurtra;
- ✓ me biseda reflektuese,
- ✓ fisha vetëvlerësimi,
- ✓ ese etj.

Vlerësimi formues (vlerësimi i vazhduar, vlerësimi për të nxënë)

Ky vlerësim bëhet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, për të parë si po ecin nxënësit. Ai ndihmon nxënësit dhe mësuesin të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur dhe çfarë duhet përmirësuar në punën e tyre para se të arrijnë vlerësimin përmbledhës ose përfundimtar.

Teknika të vlerësimit formues janë:

- ✓ vlerësimi i punës në grupe;
- ✓ vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes gjatë mësimit;
- ✓ detyrat e përditshme dhe projektet e vogla;
- ✓ vlerësimi i diskutimeve dhe argumentimi i zgjidhjeve;
- ✓ vlerësimi i përgjigjeve gjatë mësimit;
- ✓ vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët, etj.

Vlerësimi përmbledhës (vlerësimi periodik, vlerësimi i të nxënës)

Ky vlerësim bëhet pas një periudhe mësimore dhe mat atë që nxënësi ka arritur të mësojë. Mund të realizohet me detyra individuale me shkrim, konkurse, detyra përmbledhëse dhe projekte përmbyllëse. Kjo zakonisht shoqërohet me notë dhe ndihmon mësuesin, nxënësin dhe prindërit të kuptojnë progresin dhe arritjet.

7.2 Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e muzikës

- Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit të mësojnë më mirë, të kuptojnë dhe të reflektojnë mbi gabimet e tyre.
- Detyrat dhe pyetjet e vlerësimit duhet të matin aftësitë dhe njohuritë që nxënësit duhet të zhvillojnë sipas kompetencave muzikore.
- Vlerësimi duhet të jetë i qartë dhe i drejtë për të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre.

- Vlerësimi duhet të inkurajojë nxënësit të besojnë në vetvete dhe të kuptojnë që gabimi është pjesë e të nxënit.
- Mësuesi duhet të përdorë shumë forma vlerësimi, si: përgjigjet me gojë, ushtrimet, punën me materiale konkrete, projektet, vizatimet, punën në grup, detyrat e shtëpisë etj.
- Ky proces ndihmon që vlerësimi të bëhet një mjet i dobishëm dhe i kuptueshëm për të gjithë, jo vetëm një "kontroll" për nota, por një mënyrë për të ndihmuar nxënësit të rriten dhe të përmirësohen në mësimin e muzikës.

7.3 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.

Mësuesi ndërton një sërë instrumentesh për vlerësimin e nxënësit në muzikë duke iu referuar specifikave të lëndës. *Instrumentet e vlerësimit* janë të domosdoshëm për të marrë informacion lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive muzikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. Vlerësimi i nxënësve në lëndën e **muzikës** duhet të jetë **i matshëm**, duke përfshirë tregues jo vetëm për njohuritë teorike, por edhe shkathhtësitë praktike, dëgjimin muzikor, krijimtarinë dhe sjelljen gjatë aktiviteteve muzikore.

Tabela 5. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve

Shembull:			
-Rezultati i të nxënit (RN): Nxënësi shpjegon parimet e formësimit të muzikës dhe strukturën muzikore të ndërtimit të një veprë muzikore (formë - përmbajtje);			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët

- Nxënësi zotëron njohuritë për të shpjeguar parimet e formësimit të muzikës dhe strukturën muzikore të ndërtimit të një vepre muzikore (formë - përmbajtje).	- Nxënësi demonstroi njohuri të mira për të përshkruar disa parime të formësimit të muzikës dhe strukturën muzikore të ndërtimit të një vepre muzikore (formë - përmbajtje).	- Nxënësi jep disa të dhëna mbi ndonjë nga parimet e formësimit të muzikës dhe strukturën muzikore të ndërtimit të një vepre muzikore (formë - përmbajtje).	- Nxënësi ka vështirësi të thotë parimet e formësimit të muzikës dhe strukturën muzikore të ndërtimit të një vepre muzikore (formë - përmbajtje).
---	---	---	---

8 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Gjatë procesit mësimor të muzikës, përdorimi i burimeve dhe materialeve të ndryshme ndihmon në ndërtimin e një kuptimi të thellë dhe praktik të koncepteve muzikore. Materialet konkrete, vizuale por edhe teknologjike krijojnë mundësi që nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive, duke prekur, parë, dëgjuar dhe zbatuar njohuritë muzikore në situata reale. Mësuesi ka mundësinë të integrojë mjete të ndryshme për të bërë mësimin sa më të qartë dhe të aksesueshëm për të gjithë nxënësit, si:

- ✚ *materiale vizuale*: figura, tabela, postera, etj.;
- ✚ *mjete teknologjike*: projektorë, kompjuterë, tableta, magnetofon apo platforma mësimore online.

Gjatë shpjegimit, mësuesi përdor gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, fjali të shkurtra dhe një fjalor të përshtatur për moshën dhe nivelin e nxënësve. Ai/ajo zgjedh shembuj konkretë dhe ushtrime të personalizuara, duke siguruar mbështetje shtesë për nxënësit që kanë nevojë.

Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale

Përdorimi i teknologjisë ndihmon në zhvillimin e aftësive digjitale që janë thelbësore në shekullin XXI. Muzika nuk është vetëm art, por një mjet i fuqishëm edukimi që ndihmon në përgatitjen e individëve për sfidat dhe mundësitë e botës moderne. Integrimi i muzikës me teknologjinë ka transformuar mënyrën se si krijohet, shpërndahet dhe mësohet muzika në shekullin XXI. Aftësitë teknologjike zhvillohen edhe në lëndën e muzikës duke zhvilluar kompetencat lëndore në një dimension të ri.

Integrimi i teknologjisë dhe përdorimi i aplikacioneve dhe programeve muzikore gjatë mësimin ofrojnë mundësi për krijimtari, kombinimin e tingujve dhe mësim më tërheqës për nxënësit.

Disa platforma si *YouTube*, aplikacione si *Yousician*, *Simply Piano* u mundësojnë nxënësve të mësojnë muzikë në mënyrë interaktive dhe të personalizuar. Mësuesit mund të përdorin teknologji audio-vizuale për të bërë mësimet më tërheqëse dhe për të ndjekur progresin e nxënësve, p.sh. performimi dhe përdorimi i efekteve digjitale live gjatë performancës.

9 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit të lëndës së Muzikës bazohet në Kornizën Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë, Plani Mësimor i Arsimit të Mesëm të Lartë, si dhe në rekomandimet më të fundit të Bashkimit Evropian për arsimin. Si i tillë ky dokument i shërben mësuesve, vlerësuesve të jashtëm të cilësisë, prindërve, nxënësve. Në këtë rubrikë përshkruhen disa rekomandime për zbatuesit e programit në mënyrë që të zhvillohet me efektivitet programi i lëndës së muzikës.

a) Rekomandime për nxënësit

- ✓ Të marrin pjesë aktive në orët e muzikës, duke kërkuar të kuptojnë përdorimin praktik të njohurive muzikore.
- ✓ Të bashkëpunojnë me shokët si në klasë ashtu edhe jashtë saj.
- ✓ Të jenë kureshtarë dhe të kërkojnë ndihmë kur hasin vështirësi, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimeve online.
- ✓ Të kuptojnë rëndësinë e muzikës si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

b) Rekomandime për mësuesit

- ✓ Të lidhin përmbajtjen e muzikës me fusha të tjera (gjeografi, gjuhë, histori, art pamor, edukatë qytetare, TIK, etj.) për të ndihmuar kuptimin e thelluar dhe zbatimin praktik të koncepteve dhe për të kuptuar profesione të ndryshme.
- ✓ Të krijojnë aktivitete praktike që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e muzikës në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me profesione të ndryshme.
- ✓ Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët me aftësi me talente.
- ✓ Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socio - emocional.

- ✓ Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të marginalizuara.
- ✓ Të sigurojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të muzikës (p.sh. sugjerohet 40% teori — 60% praktikë). Përdorimi praktik i muzikës do të realizohet përgjatë çdo ore mësimore. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së teksteve shkollore.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së muzikës.
- ✓ Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

c) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve muzikore.
- ✓ Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- ✓ Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- ✓ Të vlerësojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të muzikës gjatë zhvillimit të orëve mësimore.
- ✓ Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënit dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- ✓ Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socio - emocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e muzikës.
- ✓ Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

d) Rekomandime për prindërit

- ✓ Të inkurajojnë të rinjtë që të kuptojnë rëndësinë e muzikës jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- ✓ Të sigurojnë që të rinjtë të ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i muzikës zhvillohet në një atmosferë të qetë dhe motivuese për fëmijët e tyre.

10 NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE

Në lëndën e muzikës së klasës së dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë ka këto ndryshime përmbajtjesore:

1. Vendosja e fokusit në situatat e veprimtarive praktike të të nxënit duke sugjeruar një ndarje 40% pjesa teorike dhe 60% pjesa praktike. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
2. Përditësimi i kompetencave kyç, dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë .
3. Përditësimi i kompetencave muzikore dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e dhjetë/njëmbëdhjetë/dymbëdhjetë .
4. Përditësimi i temave ndërkurrikulare.
5. Përditësimi i metodologjisë me fokus të shtuar në zhvillimin e mendimit kritik, krijues zgjidhjen problemore si dhe duke përfshirë të nxënit e personalizuar, të nxënit socio emocional, përdorimin e teknologjisë etj.
6. Përditësimi i vlerësimit të nxënit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënit.